

**Resul TELHAJ**  
**RISI NË VEPRËN 'PARAFJALËT E SHQIPES STANDARDE' TË**  
**PROF. DR. MEHMET ÇELIKUT**

Vepra "Parafjalët e shqipes standarde", është botuar pak kohë më parë në Tiranë, nga shtëpia botuese ILAR. Kjo vepër jo vetëm që përbën një kontribut të veçantë dhe tepër cilësor në gjuhësinë shqiptare, por në të gjenden edhe kontribute që i kalojnë kufijtë e gjuhësisë kombëtare, sepse, siç do të shtjellohet pak më poshtë, ajo përshkohet nga mendime origjinale, shtrime dhe argumentime të problemeve të përgjithshme teorike, njëkohësisht edhe zgjidhje të cilat kalojnë caqet e qëndrimeve teorike tradicionale të gjuhësisë shqiptare e më gjerë.

Botimi në fjalë, i cili nga pikëpamja strukturore, përbëhet nga 4 krerë, Kreu i parë 'Çështje teorike të parafjalëve'; Kreu i dytë 'Parafjalët njëfjalëshe'; Kreu i tretë 'Lokucionet parafjalore'; Kreu i katërt 'Lista e parafjalëve të shqipes standarde'; është një studim sinkronik i parafjalëve të shqipes, vetëm në disa raste krahasohen parafjalë të caktuara me parafjalët e përdorura gjatë Rilindjes e Pavarësisë dhe me parafjalë të dialekteve e të folmeve të shqipes. Ky punim është një trajtim leksiko-semantik e gramatikor, siç autori shënon si nëntitull, dhe ku peshën kryesore e mbajnë interpretimet semantike e morfologjike dhe më pak trajtimi i funksioneve sintaksore të ndërtimeve parafjalore. Në secilin krye të këtij punimi gjenden një numër i gjerë interpretimesh të reja, prurjesh, qëndrimesh e argumentimesh, disa nga më kryesoret do të mëtohet të paraqiten më poshtë.

Kreu i parë, *Çështje teorike të parafjalëve*, është kreu ku trajtohen në aspektin teorik disa probleme që lidhen me parafjalët, si: *natyra leksiko-gramatikore e parafjalëve, të përbashkëtat dhe dallimet midis drejtimit parafjalor dhe drejtimit rasor (eptimor), krahasimi i parafjalëve me lidhëzat nënrenditëse e lidhëzat bashkërenditëse, kuptimi leksikor i parafjalëve, klasifikimi i parafjalëve dhe terminologjia e këtij klasifikimi*. Në këto çështje lexuesit do të gjejnë këto qëndrime të reja:

1. Ndarjen e pjesëve të ligjëratës në dy grupe: *kategoria e fjalëve leksikore dhe kategoria e fjalëve gramatikore-funksionale*, tek kjo e fundit autori përfshin edhe parafjalët, për të cilat ai jep për herë të parë një përkufizim më të plotë se në botimet e mëparshme: **"Parafjalët janë fjalë gramatikore-funksionale të fjalisë së thjeshtë të vendosura para përbërësve sintaksorë të caktuar, për t'i vënë në lidhje sintaksore nënrenditëse në marrëdhënie të ndryshme semantiko-sintaksore ndaj përbërësve drejtues."** Pra, sipas këtij përkufizimi, parafjalët shihen si fjalë gramatikore dhe jo si fjalë leksikore, si mjete të realizimit të lidhjes së varësisë, dhe jo si mjete të afta për të qenë kokë e përbërësit sintaksor, siç njihen në gjuhësinë perëndimore.

2. Një tjetër qëndrim i ri për pjesët e ligjëratës është mospërfshirja e të ashtuquajturave 'pjesëza formëformuese' a 'pjesëza gramatikore', në klasën e pjesëzave, por, duke qenë se këto kanë kuptime gramatikore dhe kryejnë funksione gramatikore, trajtohen si mjete gramatikore, të ngjashme me morfemat. Kështu, mjete të tilla si: foljet ndihmëse *kam* e *jam*, pjesëza *u* e

---

joveprores, pjesëza të e lidhores, pjesëza do e së ardhmes etj. vlerësohen me të drejtë si mjete gramatikore formëformuese, njësoj si morfemat që u bashkohen temave të fjalëve për të formuar format sintetike.

3. Një tjetër risi e kreut të parë është grupimi i parafjalëve dhe lidhëzave nënrenditëse në një klasë të vetme, për të cilën autori përdor termin *parapërbërës* dhe veçimin e lidhëzave bashkërenditëse si një grup më vete. Ky grupim bëhet në bazë të karakteristikave të përbashkëta që shfaqin parafjalët dhe lidhëzat nënrenditëse, si: të qenit fjalë gramatikore-funksionale të lidhjes nënrenditëse (të varësisë), të qenit elementë të pandashëm në strukturën e përbërësve sintaksorë, të pasurit pozicion të njëjtë të paravendosura në strukturën e përbërësve, të shprehurit e marrëdhëniesve semantike të njëjta, të pasurit natyrë fjalëformuese të njëjtë, si dhe aftësia e një entiteti për të shprehur më shumë se një kuptim. Ky klasifikim është kontribut edhe për gjuhësinë teorike, dhe besojmë se këto janë argumente bindëse dhe të mjaftueshme për të mbështetur një klasifikim të tillë. Megjithëse qëndrimet e reja në gjuhësi duan kohë të pranohen, siç shprehet edhe vetë prof. Çeliku.

4. I ndryshëm nga sa jemi mësuar të lexojmë në gramatikat e shqipës dhe në punime të veçanta për parafjalët është edhe klasifikimi dhe terminologjia e përdorur në klasifikimin e parafjalëve: të cilat në këtë vepër klasifikohen në dy grupe: *parafjalë njëfjalëshe* dhe *lokucione parafjalore*. Ky klasifikim detajohet më tej me nënndarje të parafjalëve njëfjalëshe në bazë të natyrës fjalëformuese të tyre në të parme, të prejardhura dhe të përngjitura, si dhe me ndarjen lokucioneve parafjalore në bazë të komponentëve në dykomponentëshe dhe trekomponentëshe.

5. Qëndrim të ndryshëm nga më parë mban autori edhe për të ashtuquajturat lidhëza krahasore *si, se, sa/sesa*, të cilat, nisur edhe nga literatura bashkëkohore, por edhe duke i krahasuar me fjalët *nga* dhe *te/tek*, i njeh si parafjalë kur ato përdoren në fjali të thjeshtë dhe si lidhëza kur ato përdoren në fjali të përbërë (periudhë).

6. Një risi tjetër e autorit është pranimi i përdorimit të parafjalës *me* në funksion të lidhëzës bashkërenditëse këpujore dhe në shembuj të tillë si: *Shefi me Lindën ishin aty.*, ku përbërësi *Shefi me Lindën* është në funksion të kryefjalës.

Në kreun e dytë “Parafjalët njëfjalëshe”, autori trajton secilën parafjalë më vete, sipas klasifikimit origjinal të propozuar prej tij, që u përmend më sipër. Sipas këtij klasifikimi, autori trajton kuptimet dhe përdorimet sintaksore të secilës prej parafjalëve të parme *në, me, pa, për, prej, mbi, më, nën, ndër, ndaj, te/tek, deri* etj. si edhe të parafjalëve njëfjalëshe të prejardhura me konversion nga kalimi i emrave, përemrave, ndajfoljeve, foljeve në parafjalë si edhe parafjalët e përngjitura: *nëpër, përmbi, nëpërmjet, përveç, përgjatë* etj. Veç risive që përmendëm më sipër, në këtë krye lexuesit do të njihen me përdorimet e 11 parafjalëve të prejardhura emërore, të inventarizuara nga autori që më vitin 1972, në artikullin “Parafjalët emërore të thjeshta në gjuhën letrare shqipe”, botuar në SF, 1972/1; do të njihen me parafjalët e prejardhura përemërore *gjithë, plot, tërë*, të cilat nuk janë njohur më parë nga gjuhësia tradicionale shqiptare, disa parafjalë të reja ndajfoljore, si dhe parafjalët e prejardhura foljore, të cilat, veç parafjalës *falë*, që është njohur më parë, njihen për herë të parë nga profesori në artikujt “Përdorimet dhe funksionet e pjesores në gjuhën e sotme letrare shqipe” botuar në “Gjuha shqipe dhe letërsia në

---

shkollë” 11, 1986, si dhe artikullin “Parafjalët foljore dhe disa çështje të formësimit të tyre”, botuar në “Gjuha jonë” nr. 4, 1990.

Në kreun e tretë “Lokucionet parafjalore” përshkruhen kuptimet dhe përdorimet kryesore të lokucioneve parafjalore, të ndara sipas numrit të njësive që formojnë lokucionin në *lokucione dykomponentëshe* dhe *lokucione trekomponentëshe*, të klasifikuar këto në bazë të kategorisë gramatikore të njësisë kryesore të lokucionit në *lokucione emërore, përemërore, ndajfoljore e foljore*. Prurje kryesore e autorit, e cila është botuar për herë të parë në artikullin e përmendur më parë “Parafjalët emërore...” dhe është vënë në pah edhe nga Tomorr Osmani, në kumtesën “Parafjalët në gjuhën shqipe në këndvështrimin e prof. dr. Mehmet Çelikut” e mbajtur në konferencën “Mehmet Çeliku-Personalitet i gjuhësisë shqiptare” e zhvilluar për nder të 80 vjetorit të Prof. Mehmet Çelikut në Universitetin e Elbasanit, më 30 dhe 31 tetor 2015, është mospërfshirja e të ashtuquajturës njëje të gjinore si pjesë e parafjalës, siç tradita kishte bërë deri atëherë, por njohja e saj si mjet të shënimit të rasës gjinore. Po në këtë krye njihemi me argumentet kryesore që arsyetojnë gramatikalizimin e disa lokucioneve dhe kalimin e tyre në parafjalë.

Në këta dy krerë të bie në sy se përshkrim i kuptimeve dhe përdorimeve të parafjalëve njëfjalëshe dhe i lokucioneve parafjalore është i plotë, i pasur me shembuj dhe me struktura sintaksore nga më të ndryshmet. Gjithashtu, për çdo rast problemor mbahen qëndrime origjinale e argumentime bindëse, ndërsa me të drejtë lihen si të diskutueshme rastet kur ka luhajtje shkrimore dhe ku procesi i gramatikalizimit ende nuk ka përfunduar.

Kreu i katërt “Lista e parafjalëve të shqipes standarde” ku paraqiten parafjalët e shqipes standarde të ndara në të thjeshta e lokucione, të shoqëruara me shembuj, të cilët paraqesin larmishmërinë e kuptimeve dhe funksioneve që realizojnë në fjali përbërësit me parafjalë. Kjo listë mendojmë se është e plotë dhe shteruese, sepse është meritë e profesor Çelikut që ka realizuar inventarizimin e plotë të parafjalëve të shqipes, duke përfshirë edhe parafjalë për herë të parë që shfaqen të tilla (vetëm si parafjalë) në gjuhë, si edhe ato që shfaqen në gjuhë edhe si pjesë tjetër ligjërata. Sipas prof. Çelikut, numri i përgjithshëm i parafjalëve të shqipes standarde arrin 225, nga të cilat 104 janë njëfjalëshe, 78 lokucione; këtyre u shtohen edhe 43 parafjalë të diskutueshme (22 njëfjalëshe, 21 lokucione). Ndër vite, nga 1972 e deri në punimin e pranishëm, 2019, autori ka njohur mbi 50 parafjalës të reja njëfjalëshe e lokucione parafjalore të shqipes, të cilat ose nuk njiheshin më parë, ose nuk njiheshin nga të gjithë, ose parafjalë që lindën dhe u konsoliduan në gjuhë kohët e fundit.

Nga sa parashtruar më sipër mund të përmbledhim se e gjithë vepra “Parafjalët e shqipes standarde” është e mbushur me risi, në çdo interpretim të secilës parafjalë veçan, veç përshkrimeve të përgjithshme që janë bërë në gramatikat e fjalorët e shqipes, gjejmë prurje të reja origjinale të autorit. Këto risi vijnë si pasojë e njohjes së thellë të problematikës së studiuar, duke qenë se autori është marrë me këtë temë për rreth 50 vjet, që nga 1968-a kur nisi punën për studimin e parafjalëve në Institutin e Gjuhësisë dhe Letërsisë, dhe nga përditësimi i vazhdueshëm me koncepte teorike bashkëkohore.

---

Kjo vepër mund të shërbejë si literaturë e rëndësishme për lëndët e morfologjisë e të sintaksës, por edhe të ndonjë kursi special në gjuhësi. Gjithashtu ajo është një bazë e mirë për të thelluar më tej studimet, qoftë ato të rrafshit krahasimtar ndërmjet gjuhëve të tjera dhe shqipes, por edhe për të realizuar studime individuale për parafjalë të veçanta ose për grupe parafjalësh. Pra, është një vepër e cila do t'u shërbejë si pedagogëve e mësuesve të gjuhëve të huaj, edhe atyre të gjuhës shqipe.

Si përfundim, mund të themi pa dyshim se profesor Mehmet Çeliku është një nga njohësit më të mirë të strukturës gramatikore të shqipes. Ai ka lënë gjurmë edhe në studimet e tij morfo-sintaksore të tjera, si: për nyjat e rasat e emrit, për format e pashtjelluara të foljes, për përbërësit e ndryshëm të fjalisë, studime të mbështetura në materiale faktike shumë të gjera dhe të kryera në dritën e gjuhësisë bashkëkohore.